



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 107

Tiranë – E enjte, 25 qershor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9140, datë 17.6.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5757
Udhëzim i ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 18, datë 15.6.2015	Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil) me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza..... 5757
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 56, datë 4.6.2015	Autorizim i ndihmës shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore..... 5766

**DEKRET****Nr. 9140, datë 17.6.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Anila Kosta Prici
2. Zenel Telha Zoto
3. Olsi Vasil Xega
4. Kimete Ymer Shabani (Gjeta)
5. Rozeta Zef Boshkoviç (Prendi)
6. Berti Andrea Pepa
7. Sheribane Xhelo Pepa (Ajasllari)
8. Platon Berti Pepa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM**Nr. 18, datë 15.6.2015****PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E
FURNIZIMIT TË ANIJEVE TË
PESHKIMIT ME KARBURANT (GAZOIL)
ME PËRJASHTIM NGA TAKSA E
QARKULLIMIT, TAKSA E KARBONIT
DHE AKCIZA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, të ligjit 61, datë 24.5.2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar, të vendimit të nr. 205, datë 13.4.1999, të

Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, të ndryshuar si dhe të vendimit nr. 29, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të sasive, të kushteve dhe kriterëve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit”, Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

UDHËZOJNË:**I. Të përgjithshme**

1. Ky udhëzim zbatohet për furnizimin e anijeve shqiptare të peshkimit me karburant (gazoil), sipas përcaktimeve të ligjit 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar pa paguar akcizë, taksë qarkullimi dhe taksë karboni.

2. Furnizohen me karburant (gazoil) për peshkim, pa paguar (me përjashtim) taksën e qarkullimit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48), taksën e karbonit sipas kodeve të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48 dhe akcizën, por duke paguar TVSH-në, subjektet e peshkimit (personat juridikë dhe fizikë) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, të cilat kanë marrë statusin e pritësit të regjistruar dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 20 të vendimit nr. 612 datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit 61/2012 “Për akcizat””, të ndryshuar.

3. Karburanti (gazoili) për peshkim duhet të jetë i ngjyrosur, me ngjyresin fiskal të standardit të BE-së (Solvent Yellow 124) me emër shkencor N-Ethyl-N-[2-[1-(2-methylpropoxy)ethoxy]ethyl]-4-phenyldiazenylaniline.

Niveli i ngjyrit llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

Për çdo 100 kg gazoil:

- a) [0,95 gr. Solvent Yellow 124 dhe 0,51 gr. naftë tretëse];
 - b) 3 gr. të «shënjesit RS»;
 - c) 13 gr. toluol ose xilol, teknikisht të pastër;
 - d) 5 gr. “jeshil alizarina G base”.
- a) Solvent Yellow: me emër shkencor N-Ethyl-



N-[2-[1-(2-methylpropoxy)ethoxy]ethyl]-4-phenyldiazenylaniline.

b) “Shënjues RS” është substanca kimike e përbërë nga 2-etil-antrachinone me peshë molekulare = 236,27, pikë vlimi më të madhe se 300° C dhe pikë shkrirjeje 108 ° C (përfshirë) deri 111° C.

c) “Jeshil alizarina G base”: 1,4-bis [(4-metilfenil)-ammino]-9,10 antracendione që i korrespondon produktit të emërtuar si Color Index solvent green 3 ose Color Index 61565, në solucion xilolik i tillë që të ketë një përqindjeje shtrirjeje me gjatësi vale prej 607 nm të 126 dhe të 645 nm të 130.

Përqendrimi i ngjyrosjes gjatë gjithë kohës së tregtimit/përdorimit të karburantit (gazoil) të ngjyrosur duhet të jetë i njëjtë me përqendrimin në çastin e ngjyrosjes në përputhje me normativat e mësipërme.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, listën e subjekteve aktive të peshkimit të cilat janë të regjistruar në organet tatimore si subjekte të TVSH-së, jo më vonë se data 31 janar e çdo viti.

5. Drejtoria që mbulon peshkimin, pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin, i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, listën me emrat e subjekteve të peshkimit të pajisur me leje peshkimi dhe që janë subjekte të rregullta me detyrimet sipas legjislacionit të peshkimit, si dhe çdo ndryshim periodik në këtë listë jo më vonë se data 31 janar të çdo viti.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dërgon zyrtarisht tek të gjitha subjektet furnizuese me karburant (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, të cilat kanë magazina doganore, magazina të lira ose magazina fiskale, listën e subjekteve të peshkimit të regjistruar sipas nenit 20 të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, të ndryshuar, si dhe të gjitha ndryshimet periodike të tyre, jo më vonë se data 31 janar e çdo viti.

7. Shtojcat 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

II. Furnizuesit me karburant (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit

8. Subjektet e peshkimit mundet të furnizohen

brenda vendit me karburant (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, vetëm pranë operatorëve ekonomik (shoqëritë furnizuese) të cilat administrojnë magazina të lira, magazina doganore ose magazina fiskale dhe që janë të autorizuar nga autoritetet doganore për të kryer ngjyrosje.

Magazina e lirë, magazina doganore ose magazina fiskale ndërpret furnizimin me karburant (gazoil) për peshkimin, të subjekteve të peshkimit, sipas njoftimit të autoriteteve doganore.

9. Subjektet e peshkimit mundet të furnizohen edhe jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që karburanti (gazoili) të jetë i ngjyrosur sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij udhëzimi.

III. Procedurat e furnizimit me karburant (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit

A. Brenda vendit

10. Subjektet furnizuese (operatorët ekonomikë) të cilët administrojnë magazina të lira, magazina doganore ose magazina fiskale dhe që janë të autorizuar nga autoritetet doganore për të kryer ngjyrosje të karburantit (gazoilit) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, duhet të njoftohen nëpërmjet një kërkesë me shkrim nga subjekti i peshkimit, i cili kërkon të furnizohet me karburant (gazoil) të paktën 3 ditë përpara furnizimit, sipas modelit të kërkesës bashkëlidhur në shtojcën 2, të këtij udhëzimi.

Shoqëritë furnizuese njoftojnë zyrën doganore mbikëqyrëse territorialisht kompetente, për furnizimin e subjekteve të peshkimit, të paktën një ditë përpara furnizimit me karburant (gazoil) të subjekteve të peshkimit.

Shoqëria furnizuese duhet të regjistrojë në regjistrat e saj lëvizjen e karburantit (gazoilit) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11. Të gjitha lëvizjet e karburantit (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit që do të kryen nga subjektet e peshkimit duhet të shoqërohen;

- Kur dalin nga magazina doganore/magazina e lirë, nga deklarata doganore IM4 (me TVSH, por pa taksën e qarkullimit, taksën e karbonit dhe akcizën), si dhe dokumentacionin përkatës



(faturat e shitjes dhe kuponët fiskalë të lëshuar nga magazina doganore/magazina e lirë).

- Kur dalin nga magazina fiskale, me DSHA me akcizë të përjashtuar, si dhe dokumentacioni përkatës (faturat e shitjes dhe kuponët fiskalë të lëshuar nga depozituesi i miratuar, magazina fiskale, me TVSH, por pa taksën e qarkullimit, taksën e karbonit).

Karburanti (gazoil) quhet i çliruar për qarkullim të lirë/hedhur për konsum në mënyrë të rregullt vetëm nëse shkarkimi i autobotit bëhet në serbatorin e anijes së peshkimit. Përgjegjës për këtë procedurë është pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit, përfitues.

Furnizimi i anijeve të peshkimit bëhet nën mbikëqyrjen e doganierit të kontrollit fizik të zyrës doganore dhe punonjësit të antikontrabandës detare.

Autoboti me të cilin do të transportohet karburanti (gazoil), duhet të plotësojë kushtet e plumbosjes, sipas kriterëve të miratuara në aktet nënligjore në fuqi.

Karburanti (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, i blerë nga subjektet e peshkimit, nga momenti i daljes nga magazina doganore, magazina e lirë ose magazina fiskale është në ngarkim të pritësit të regjistruar/subjekt i peshkimit.

Në rast se konstatohet se karburanti (gazoil) nuk ka pasur destinacion përdorimi në anijen e peshkimit për të cilin ka përfituar përjashtimin nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit, pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit detyrohet të paguajë shumën e plotë të detyrimit të akcizës, taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit së bashku me penalitetet respektive.

B. Jashtë vendit/territorit doganor të Republikës së Shqipërisë

12. Në rastin kur pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit kërkon të furnizohet me karburant (gazoil) me destinacion përdorimi në anijet e peshkimit, në një port jashtë vendit, ky subjekt njofton zyrën doganore portuale ku ndodhet anija e peshkimit dhe kjo e fundit regjistron sasinë e karburantit (gazoil) që ndodhet në anijen e peshkimit në momentin e nisjes.

Në momentin e kthimit të anijes së peshkimit nga porti i huaj në të cilin është furnizuar me karburant (gazoil), anija e peshkimit depoziton pranë zyrës doganore pritëse, deklaratën

doganore IM4 (me TVSH, por pa taksën e qarkullimit, taksën e karbonit dhe akcizën) për karburantin (gazoil) e peshkimit, së bashku me faturën e blerjes së tij dhe dokumentet e tjerë doganorë. Zyra doganore pritëse/portuale, ku ndodhet anija e peshkimit, kryen procedurat doganore dhe vjel vetëm detyrimin e tatimit mbi vlerën e shtuar bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i peshkimit, si dhe të sasisë gjendje në anijen e peshkimit (rezultuar nga sasia e regjistruar në nisje, plus sasia e blerë sipas faturës, minus sasia e konsumuar gjatë udhëtimit vajtje-ardhje për në portin jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kthim).

IV. Mbikëqyrja dhe rakordimet

13. Pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit duhet të justifikojë pranë autoriteteve doganore, sasinë e karburantit (gazoil) për peshkim të furnizuar nëpërmjet dokumenteve doganore, faturës së karburantit (gazoil) për peshkim të blerë, me faturat tatimore me TVSH të produktit të peshkimit të shitur, regjistrin të karburantit (gazoil) të anijeve të peshkimit ku janë shënuar sasi të furnizuara, konsumi dhe lëvizjet e anijes së peshkimit.

14. Vlera totale e karburantit (gazoil) për peshkim, të furnizuar dhe konsumuar gjatë një 6-mujori, nuk mund të jetë më e madhe se 80% e vlerës totale të produktit të peshkimit, të shitur me faturë tatimore me TVSH, gjatë kësaj periudhe.

15. Rakordimi, për efekt të llogaritjeve të kufizimit të përcaktuar në pikën 14 më sipër, bazohet si më poshtë:

a) sasia e karburantit (gazoil) për peshkim të furnizuar është konsumuar nga subjekti i peshkimit totalisht në 6-mujorin e parë nga data e fillimit të funksionimit të skemës, rakordimi do të bëhet ndërmjet vlerës totale të faturave të blerjes së karburantit (gazoil) për peshkim dhe vlerës totale të produkteve të peshkimit të shitura me faturë tatimore me TVSH.

b) sasia e furnizuar e karburantit (gazoil) për peshkim nuk është konsumuar e gjitha brenda 6-mujorit të parë, rakordimi do të kryhet mbi bazën e krahasimit ndërmjet vlerës totale të faturave të karburantit (gazoil) të konsumuar dhe vlerës totale të produkteve të peshkimit të shitura me faturë tatimore me TVSH.



16. Vlera totale e karburantit (gazoil) për peshkim të konsumuar nga pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit, përcaktohet duke iu referuar regjistrit të anijes së peshkimit, një kopje e të cilit depozitohet nga subjekti i peshkimit pranë zyrës doganore mbikëqyrëse të subjektit në fjalë, konsumit të karburantit (gazoil) për peshkim, çmimit të faturave korresponduese të karburantit (gazoil) për peshkim, si dhe inventarit të karburantit (gazoil) vlera (sasia) e të cilit llogaritet nga punonjësit doganor mbi bazën e metodës FIFO (hyrje e parë, dalje e parë). Duke përdorur këtë metodë, nga sasia totale e karburantit (gazoil) të faturuar, pasi zbritet sasia e karburantit (gazoil) të konsumuar nga subjekti i peshkimit (sipas regjistrit të konsumit të karburantit të anijes, orët e punës (x), konsumin orar/mes) sasia e mbetur e karburantit (gazoil) gjendje në fund të periudhës vlerësohet me çmimet korresponduese të sasive përkatëse sipas datave të furnizimit dhe rakordohet me subjektin e peshkimit.

17. Diferenca e vlerësuar me çmimet korresponduese të blerjes së karburantit (gazoil) për peshkim, do të mbartet për periudhën e ardhshme ushtrimore dhe do të mbahet në konsideratë për rakordim periodik gjatë 6-mujorit në vijim.

18. Zyra doganore mbikëqyrëse e pritësit të regjistruar/subjekt i peshkimit, për efekt rakordimi, për të kryer inventarin e gjendjes faktike të karburantit (gazoil) në serbatorin e anijes, bashkëpunon me zyrën doganore pritëse/nisëse sipas rastit.

19. Çdo dy muaj, brenda datës 10 pasuese, pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit depoziton në zyrën doganore mbikëqyrëse, kopje të faturave tatimore të produktit të peshkimit të shitur, si dhe listën me deklaratat IM4 apo DSHA, të karburantit (gazoil) për peshkim të furnizuar.

20. Zyra doganore mbikëqyrëse krijon regjistrin/dosjen përkatëse për çdo pritës të regjistruar/subjekt i peshkimit. Regjistri përmban të gjitha të dhënat e këtyre subjekteve, si dhe të dhëna mbi deklaratat IM4 apo DSHA sipas rastit, datat e furnizimit, sasinë dhe vlerën e produktit të peshkimit të shitur me faturë tatimore, sasinë dhe vlerën e karburantit (gazoil) të furnizuar, si dhe sasinë dhe vlerën e karburantit (gazoil) të konsumuar.

21. Referuar regjistrit/dosjes përkatëse, zyra doganore mbikëqyrëse ndjek ecurinë e furnizimit

me karburant (gazoil) të subjekteve të peshkimit dhe çdo 6-mujor pritësi i regjistruar/subjekt i peshkimit dhe zyra doganore mbikëqyrëse bëjnë rakordimin midis faturave të karburantit (gazoil) për peshkimin të blerë (konsumuar) dhe faturave të peshkut të shitur me faturë tatimore me TVSH. Për të bërë rakordimin, subjekti duhet të paraqitet pranë zyrës doganore mbikëqyrëse, brenda maksimumi 15 ditëve nga përfundimi i afatit 6-mujor.

Pritësit e regjistruar/subjekte të peshkimit, me kërkesë, mund të bëjnë rakordimin e mësipërm edhe përpara përfundimit të afatit 6-mujor.

22. Nëse pritësit e regjistruar/subjekte të peshkimit tejkalojnë afatin e mësipërm të rakordimit, zyra doganore mbikëqyrëse urdhëron shoqëritë furnizuese për ndërprerjen e menjëhershme të furnizimit me karburant (gazoil) për peshkimin për subjektin e peshkimit, dhe njofton Kapitanerinë e Portit për moslejimin e anijes të niset për furnizim jashtë vendit, deri në momentin e kryerjes së rakordimit. Nëse edhe pas kësaj ndërprerjeje ky rakordim nuk kryhet brenda një periudhe 15-ditore, zyra doganore mbikëqyrëse fillon menjëherë kontrollin e pritësit të regjistruar/subjekte të peshkimit.

23. Në rast se vlera e të gjitha faturave të karburantit (gazoil) të konsumuar të faturuar për peshkimin për një 6-mujor është më e vogël ose e barabartë me 80% të vlerës totale të faturave të produkteve të peshkimit të shitura me TVSH për këtë periudhë, zyra doganore mbikëqyrëse nënshkruan aktin e rakordimit me subjektin e peshkimit dhe ky i fundit mundet të vijojë furnizimin me karburant (gazoil) për peshkimin deri në njoftimin zyrtar për ndërprerjen e tij nga autoritetet doganore.

24. Në rast se një subjekt juridik peshkimi disponon më shumë se një anije peshkimi dhe këto anije identifikohen me një numër të vetëm regjistrimi (NUIS/NIPT), por me emra të ndryshëm, procedura e rakordimit ndërmjet këtij subjekti peshkimi dhe zyrës doganore mbikëqyrëse është e njëjtë sikur po rakordohet për një anije të vetme dhe rakordimi kryhet duke krahasuar vleftën totale të karburantit (gazoil) për peshkimin, të furnizuar (konsumuar) për të gjitha mjetet e këtij subjekti për periudhën e rakordimit me vleftën totale të produktit përfundimtar të peshkimit, të shitur me faturë tatimore me TVSH, të faturuar



nga të gjitha këto mjete, për të njëjtën periudhë rakordimi.

25. Zyra doganore mbikëqyrëse duhet të njoftojë subjektin e peshkimit për moslejimin e anijes të niset për furnizim jashtë vendit dhe furnizuesit e karburantit (gazoil) për ndërprerjen e furnizimit, në momentin kur konstaton se vlera e të gjitha faturave të karburantit (gazoil) të furnizuar (konsumuar) për peshkimin është më e madhe se 80% e vlerës totale të faturave të produkteve të peshkimit të shitura, për periudhën 6-mujore të rakorduar.

26. Subjekti i peshkimit, i cili, pas rakordimit me zyrën doganore mbikëqyrëse, rezulton me tejkallim të kufirit 80% të vlerës së gazoilit të furnizuar (konsumuar) ndaj vlerës së produktit të peshkimit të faturuar në shitje për periudhën e rakorduar, për t'u rifutur në skemën e përfitimit të furnizimit me karburant (gazoil) për peshkim, duhet të vërtetojë me dokumentacion plotësues (kredi në bankë, biznes tjetër, etj.) financimin e humbjes në aktivitetin e peshkimit. Në rast të kundërt, duhet të paguajë për llogari të autoriteteve doganore, të gjithë vlerën e plotë të akcizës, taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit për sasinë e tejkalluar të faturimit (konsumit) të karburantit (gazoil). Nga data e shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, subjektit të peshkimit i lind e drejta të rifutet në skemë, për një periudhë tjetër 6-mujore.

27. Anijet e peshkimit që kanë të drejtë të furnizohen me karburant (gazoil) për peshkimin duhet të jenë të pajisura me një regjistër të karburantit (gazoil) për anijet e peshkimit sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi, në të cilin duhet të jenë të regjistruara sasitë e furnizuara dhe konsumi i karburantit (gazoil). Regjistri përbëhet nga tri pjesë:

a) Në pjesën e parë shënohen karakteristikat e anijes së peshkimit, sipas dokumentacionit të anijes së peshkimit që mbahet në bordin e saj dhe me të dhënat teknike të motorit, konsumit mesatar orar në raport me fuqinë motorike.

b) Në pjesën e dytë shënohen ngarkim-shkarkimi i karburantit (gazoil) të kryer dhe të dhënat e kontratës së nënshkruar midis anijes së peshkimit dhe furnizuesit.

c) Në pjesën e tretë shënohen orët e punës dhe konsumi i karburantit (gazoil).

Shënimet në pjesën e parë duhet të vërtetohen

nga Kapitaneria e Porteve sipas të dhënave të regjistrit detar në pjesën e dytë nga përfaqësuesi i doganës dhe kapiteni i anijes, në pjesën e tretë nga kapiteni i anijes së peshkimit. Kapiteni i anijes së peshkimit ruan në bord të gjitha dokumentet për nisjet dhe hyrjet e kryera nga Kapitaneria e Porteve të cilat janë pjesë e dokumentacionit të anijes së peshkimit.

28. Anijet e peshkimit mbi 10 metra gjatësi që kanë të drejtë të furnizohen me karburant (gazoil) për peshkimin, duhet të dorëzojnë në drejtorinë që mbulon peshkimin, librin e anijes sipas përcaktimit në shtojcën 4 të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim". Sasitë e regjistruara në librin e anijes së peshkimit duhet të përputhen me sasitë në faturat e peshkut të shitur me TVSH. Në rast të mosdorëzimit të librit të anijes, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 407, datë 8.5.2013, drejtoria që mbulon peshkimin pranë ministrisë përgjegjëse për peshkimin dërgon njoftim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për përjashtimin e anijes nga skema e furnizimit me karburant (gazoil).

V. Kontrolli për administrimin e skemës së shpërndarjes së karburantit (gazoil)

29. Autoritetet doganore dhe tatimore mund të verifikojnë/kontrollojnë vërtetësinë e regjistrimeve në regjistrat e furnizimit të anijeve të peshkimit dhe të konsumit të karburantit (gazoil) dhe të zbatimit nga ana e subjekteve të peshkimit të rregullave dhe procedurave të përcaktuara me këtë udhëzim dhe legjislacionin në fuqi. Pas çdo kontrolli, ku përfshihet edhe marrja dhe analizimi i mostrave për matjen e përqendrimit të ngjyrosësit pranë Laboratorit Doganor, mbahet procesverbali përkatës.

Në rast se konstatohen shkelje të procedurave, rregullave për administrimin dhe menaxhimin e këtij procesi, pavarësisht nëse parashikohet nga ligji si vepër penale ose jo, organet doganore dhe tatimore zbatojnë respektivisht masat e përcaktuara në ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar ose ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",



të ndryshuar, si dhe subjektit të peshkimit i hiqet e drejta e përfitimit të karburantit (gazoil) pa akcizë, taksë qarkullimi dhe taksë karboni.

30. Brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria që mbulon peshkimin, pranë ministrisë përgjegjëse të peshkimit, dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave informacionin respektivisht sipas pikës 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA 1

Pjesa I

REGJISTËR I FURNIZIMIT ME GAZOIL
MOTOBARKA:_____

PORTI:_____

MOTOBARKA_____

PRONARI_____

NR. LEJES SË PESHKIMIT_____

NR. I REGJISTRIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT_____

TË DHËNAT E MOTORIT

MARKA E FABRIKIMIT DHE LLOJI_____

FUQIA (KË) _____

VITI I PRODHIMIT _____

KONSUMI MESATAR I (LIT/ORE)_____

GJATËSIA E MJETIT TË PESHKIMIT_____


KAPITANERIA E PORTIT
VULA



Pjesa II

FURNIZIMI ME KARBURANT (GAZOIL)

DATA	Dokumenti shoqërues Imp4, DSHA me përfashtim		Sasia e karburantit (gazoil) të furnizuar	Të dhënat e kontratës	Firma e kapitenit të anijes së peshkimit	Firma e punonjësit të doganës
	Numri	Data	Litra			



Pjesa III

KONSUMI I KARBURANTIT (GAZOIL)

Data	Ora e nisjes	Data	Ora e mbërritjes	Orë pune të kryera	Konsumi efektiv i karburantit(gazoil)	Kapiteni i anijes
				Totali		



SHTOJCA 2

K Ë R K E S Ë

_____ me _____.20__

Drejtuar: Subjektit furnizues _____ me magazinë doganore/lirë/fiskale në

Me numër NIPT' _____

Me adresë _____

Nga: Subjekti i peshkimit (pritësi i regjistruar) _____

Me numër NUIS/NIPT' _____

Përfaqësues i anijes së peshkimit _____

Me numër regjistri në Regjistrin e Mjeteve Lundruese të Peshkimit ALB _____

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 612 datë 5.9.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat””, të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 14.1.2015, “Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga akciza, taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit” dhe të udhëzimit nr. ____ datë ____ 2015, subjekti i peshkimit _____ kërkon të furnizohet me gazoil për peshkimin për anijen e peshkimit _____ në sasinë prej _____ (sasia në fjalë) litra. Ky furnizim do të kryhet me datë _____.20__, pranë magazinës suaj, në orën ____.

Për sa më sipër lutemi, njoftimin e zyrës doganore _____ për ndjekjen e procedurave të furnizimit të gazoilit për anijen e peshkimit.

Pritësi i regjistruar /subjekt i peshkimit**Emër, mbiemër, nënshkrimi, vula**



VENDIM

Nr. 56, datë 4.6.2015

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE PËR VEPRIMTARITË,
TË MIRAT DHE SHËRBIMET
KULTURORE**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Maçellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 4.6.2015, shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Kulturës dhe vendosi të lejojë ndihmën shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore në përputhje me parashikimet e nenit 13, shkronja “ç” të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

I. PROCEDURA

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), me shkresën nr. 8436, datë 9.12.2014 dhe nr. 592, datë 22.1.2015, i kërkoi Ministrisë së Kulturës informacion në lidhje me vlerën e fondeve të miratuara nga buxheti i shtetit, të shoqëruar me përshkrimin e skemës së ndihmës/mbështetjes, qëllimin e përdorimit, përfitues/it, kohëzgjatjen e skemës për punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit dhe të rigjallërimit të monumenteve të kulturës dhe muzetë, si edhe mbështetjen financiare për veprimtaritë kulturore në fushën e artit dhe kulturës dhe prodhimeve kinematografike.

2. Me shkresën nr. 279/1 datë 10.4.2015, Ministria e Kulturës paraqiti të dhënat e kërkuara pranë Sektorit të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, në Drejtorinë e Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) për skemën e ndihmës shtetërore në favor të personave, juridikë dhe fizikë aktivë, ofrimin e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore¹.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

3. Skema ka si qëllim mbështetjen dhe nxitjen e kulturës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, përmirësimin e strukturës së industrisë shqiptare të filmit, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e saj.

4. Dhënës i ndihmës është Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për zbatimin e politikave kulturore dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë, si institucioni përgjegjës për shpërndarjen e fondit buxhetor për gjinitë e filmit (artistik, dokumentar e të animuar).

5. Aktivitetet të cilat përfitojnë nga ndihma shtetërore janë si më poshtë:

- Për prodhimin artistik, edukimin, rritjen e zhvillim audiencash, ngritjen e kapaciteteve, kryerjen e aktiviteteve kulturore, hulumtim dhe zhvillim, etj.;

- Për punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit, të zbulimit dhe të studimit të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe muzetë;

- Për projektet kinematografike, prodhimin dhe shpërndarjen e filmave artistikë me metrazh të ndryshëm, filmave dokumentarë, të animuar, projektet për filmat independentë me metrazh të ndryshëm, etj.

6. Përfitues të ndihmës janë:

- Në fushën e artit dhe kulturës:

Personat juridikë dhe fizikë, të cilët paraqesin projektpropozimet që shprehin: ide novatore, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, garantojnë cilësi dhe profesionalizëm në realizim, mundësi për rritjen profesionale të artistit, sjellin zhvillim dhe gjallërim të skenës artistike e kulturore në Shqipëri, dëshmojnë respektimin e të drejtës së autorit.

- Në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve:

Personat juridikë dhe fizikë, të licencuar nga Ministria e Kulturës për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, si edhe muzetë publikë.

- Në fushën e prodhimeve kinematografike:

Personat juridikë dhe fizikë, të cilët realizojnë vepra filmike dhe realizojnë tregtimin apo shpërndarjen e veprave filmike.

7. Baza ligjore: neni 26 i ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar,

¹Shqipëria u bë palë e Konventës për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore më 17.11.2006, ku në nenin 4 përcaktohet se: “**Veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore**” janë veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet që në kohën kur janë konsideruar si një atribut, përdorim apo qëllim specifik, mishërojnë ose

përcjellin shprehje kulturore, pavarësisht nga vlera tregtare që mund të kenë. Veprimtaritë kulturore mund të jenë qëllim në vetvete ose mund të kontribuojnë në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve kulturore.



neni 19 i ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë” dhe neni 5 i ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

Referuar akteve ligjore të sipërcituara, si edhe mbi bazën e ligjit të buxhetit të shtetit, kryhet financimi dhe përdorimi i burimeve shtetërore për mbështetjen e projekteve kulturore, veprimtarisë së muzeve, si edhe mbështetja për industrinë shqiptare të filmit, duke e shtrirë zbatimin e tyre në vitet pasardhëse. Gjatë vitit 2015, nëpërmjet ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, skema parashikon dhënien e ndihmës në vlerën gjithsej 225, 75 mln lekë, e ndarë sipas kategorive:

- Në fushën e artit dhe kulturës: 47, 65 mln lekë (për 82 projekte fituese).

- Në fushën e muzeve: 70,1 mln lekë (muzeu Arkeologjik Durrës 56.6 mln lekë dhe për muzeun “Gjethi” 13.5 mln lekë).

- Në fushën e prodhimeve kinematografike: 108 mln lekë.

8. Procesi i përzgjedhjes. Aplikuesit e projekteve në fushën e kulturës duhet të përmbushin disa kërkesa, si p.sh. identifikimin e lidhjes së objektivit të projektit dhe qëllimit për të cilin jepet granti, etj.

III. VLERËSIMI

1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

9. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

10. Skema e njoftuar nga Ministria e Kulturës lejon vetëm një numër të caktuar dhe të përzgjedhur të personave fizikë dhe/ose juridikë, muze publikë për të përfituar burimeve shtetërore, fonde nga buxheti i shtetit, për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të tyre që lidhen me kryerjen e aktiviteteve sipas fushave, në pamundësi të burimeve të veta financiare^{2,3,4}. Ministria e

Kulturës^{5,6} me fonde nga buxheti i shtetit mbështet projektet e paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të shpallura fituese, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre fushën e kulturës (sektori i artit dhe kulturës, muzeve dhe prodhimeve kinematografike). Shuma e ndihmës shtetërore për secilën kategori janë shumë të kufizuara. Pra, ndikimi në konkurrencë është i kufizuar, edhe pse këta përfitues konkurrojnë me ndërmarrjet e tjera, të cilat nuk përfitojnë ndihmë sipas skemës.

11. Si rrjedhojë, në interpretim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, skema e ndihmës shtetërore e njoftuar përbën ndihmë shtetërore.

2. Ligjshmëria e ndihmës

12. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Kulturës ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 13, shkronja “ç” “ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke e njoftuar masën e ndihmës.

3. Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. Në bazë të nenit 13, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ndihma shtetërore mund të lejohet nëse ajo “nxit zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë”.

14. Objektivi kryesor për miratimin e fondeve buxhetore është promovimi i veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore, duke ofruar produkte kulturore të një rëndësie të lartë artistike në fushat e artit, muzeve dhe kinematografisë. Sipas informacionit të paraqitur nga Ministria e Kulturës, skema e ndihmës përmirëson performacën në art, mbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave të muzeve publikë, prodhimin dhe shpërndarjen e filmit që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar duke përfituar artistët dhe publiku. Pra, skema

² State aid N 477/2008 – German Film Support Scheme, Germany

³ State aid – SA.33470 (2011/N) – Hungarian Cultural Heritage, Hungary

⁴ State aid 32643 (2011/N) – State aid to Basque Museums in 2011, Spain

⁵ Formular aplikimi (B1) Projekt Kinematografik: nationalfilmcenter.gov.al/formulare/

⁶ Thirrje për projektpropozime në art-kulturë, formular për aplikim për fonde dhe/ose mbështetje: www.kultura.gov.al/al/newsroom/njoftime/thirrja-per-projekt-propozime-2015.



synon të mbështesë aktivitete kulturore dhe të përmirësojë aksesin e publikut gjatë zhvillimit të tyre.

15. Paragrafët e mëposhtëm paraqesin një informacion të detajuar lidhur me mbështetjen dhe impaktin e saj në aktivitetet kulturore:

- Arti dhe kultura

Mbështetja financiare e projekteve të paraqitura në fushën e artit dhe kulturës për vitin 2014 ishte 107 mln lekë.

- Muzetë

Mbështetja financiare për fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve kombëtare për vitin 2014 ishte 75.97 mln lekë. Sipas përcaktimit në nenin 19, pika 1 e ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, “Për muzetë”, financimi i muzeve publike me burime nga buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave muzeore, pagesën e shërbimeve të nevojshme, zgjerimin e ndërtesave muzeore, ruajtjen e tyre etj. Sipas të dhënave të Ministrisë së Kulturës rezulton se numri i vizitorëve në muzetë kombëtarë për vitin 2013 ishte 41,343 persona, ndërsa në vitin 2014 ishte 72,568 persona.

- Prodhimet kinematografike

Tabela pasqyron shumën e akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2014 dhe numrin e projekteve të realizuara.

Emri i produktit	Fakti vjetor 2014	Nr. i projekteve që kanë përfituar ndihmë shtetërore
Filma artistikë me metrazh të gjatë	47.455,0	5
Filma artistikë, vepër e parë	18.712,0	3
Film i shkurtër artistik	4.699,0	4
Filma dokumentarë	6.460,0	4
Filma vizatimorë	625,0	1
Fin. proj. festivale		4
Botime, aktiv.	90,0	
Proj. të ndryshme kinematografike	2.264,0	
TOTALI	80.305,0	21

16. Sa më sipër, qëllimi i skemës është kryesisht promovimi i një game të gjerë të aktiviteteve kulturore siç vërehet nga shumëllojshmëria e fushave kulturore të mbështetura në kuadër të skemës.

17. Karakteri kulturor i aktiviteteve është i reflektuar edhe në kriteret e zbatuara nga

Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës për të zgjedhur projektet në fushën e artit dhe kulturës apo Këshilli Miratues i Projekteve për përzgjedhjen e projekteve në fushën e kinematografisë. Pra ndihma jepet direkt për mbështetjen e projekteve të mirëfillta kulturore.

18. Skema e ndihmës shtetërore është e nevojshme për të mbrojtur, për të nxitur dhe për të siguruar shpërndarjen e aktiviteteve kulturore, të cilat do të zhvillohen në vend, si dhe për të lehtësuar aksesin e publikut të gjerë ndaj tyre.

19. Aktivitetet që do të financohen në bazë të skemës janë jofitimprurëse dhe shumë prej tyre nuk do të kryheshin pa mbështetjen e shtetit. Pra, mund të konsiderohet se masa është e nevojshme dhe se ka formë nxitëse duke stimuluar kryerjen e investimeve private.

20. Sa më lart, Komisioni konsideron se masa është e nevojshme dhe proporcionale me objektiv promovimin e kulturës në vend dhe ka impakt të papërfillshëm në kushtet e tregtisë së lirë dhe të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13 shkronja “a”, 17 shkronja “ç”, 22 pika 2, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore, mbështetur në nenin 13, shkronja “ç” të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, në përputhje me zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë së lirë dhe të konkurrencës.

2. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë në cilësinë e dhënësit të ndihmës brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006